

## Akti i Themelimit

**"B Limitless"**  
**Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)**

Sot, më datë 19/04/2023 e nënshkruara:

- **Znj. Boralda Minaj, e bija e Tahir-it, lindur më 07/06/1994, banuese në rrugën Panorama, pll.4, shk.7, Ap.30, kodi postal 1057, Nj.a 9 , Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër J45607092R.**

Me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "(Ligj i Shoqerive) kam vendosur të krijoj shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar "**B Limitless**" (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themelim

### Emri dhe forma ligjore

#### Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë "**B Limitless**" ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(Ligji i Shoqerive)

### Selia dhe kohezgjatja

#### Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Panorama, pll.4, shk.7, Ap.30, kodi postal 1057, Nj.A 9 , Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjeter të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm

### Objekti i veprimtarisë

#### Neni 3.

- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor: **Veprimtari në fushën e marketingut dhe organizimin e eveneve të ndryshme shqiptare dhe të huaja në territorin e Shqipërise dhe jashtë kufijve te saj.**
- 3.2 . Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë sic parashikohet në këtë Akt.



### Kapitali Themeltar

#### **Neni 4.**

- 4.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 1000 (Një mijë) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me një vlerë nominale 1000 (Një mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit
- 4.2. Ortaku i vetëm themelues:

- Znj. Boralda Minaj, e bija e Tahir-it, lindur më 07/06/1994, banuese në rrugën Panorama, pll.4, shk.7, Ap.30, kodi postal 1057, Nj.a 9, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J45607092R., zotëruese e një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.

### Organet drejtuese dhe Administrimi

#### **Neni 5.**

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
- Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
  - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratore i Shoqërisë do të jetë: Znj. Boralda Minaj e cila e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejte rinnovimi.

### Dispozita Përfundimtare

#### **Neni 6.**

- 6.1 Cdo cështje tjeter, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themeli, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Akt Themeli hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i vetem i Shoqërisë, sot më datë 19/04/2023 gjuhën shqipe në dy kopje.

**ORTAKU THEMELUES  
BORALDA MINAJ**

